

BULETINI INNOVET ALBANIA

Le të kontribuojmë drejt një komuniteti më të fortë të Arsimit dhe Formimit Profesional!



I dashur lexues,

Eshtë një kënaqësi për mua që të bëj hapjen e buletinit të 10-të, dhe mbi të gjitha është një kënaqësi të them pak fjalë mbi tranzicionin e gjelbër. Unë jam Françoise Korançe, prej vitesh tashmë pjesë e shoqërisë civile në frontin e kërimit, advokimit dhe projekteve në mjedis, ndryshimeve klimatike dhe zhvillimit të qëndrueshëm, dhe përgjatë vitit të fundit edhe kërkuese shkencore dhe lektore pranë Universitetit Polis në departamentin e mjedisit.

Njohja ime me tranzicionin e gjelbër është shumë e hershme, që prej vitit 2011, gjatë një trajnimit në Parlamentin Europian, në të cilin u prezantova me European Green Deal, pikërisht në gjenezën e saj pranë partisë së gjelbër europiane (European Greens). European Green Deal është tashmë pjesë e paketës së politikave europiane, dhe ka filluar implementimin e saj me një sërë paketash ligjore. Me nënshkrimin e marrëveshjes në Sofje në vitin 2020, Green Deal një iniciative e marrë edhe nga Ballkani Perëndimor, rrjedhimisht dhe një detyrim për Shqipërinë për të avancuar në këtë drejtim.

Së bashku me ekipin e Albanian Skills mundëm të kishim një bashkëpunim tejet frytdhënës përgjatë Javës së Aftësive. Një event mjaft informativ mbi atë çfarë është dhe çfarë përfaqëson tranzicioni i gjelbër si dhe sfidat të cilat e rrethojnë shpesh atë. Ishte tejet interesante po aq dhe pozitive fakti që ftesa për të kryer një aktivitet lidhur me tranzicionin e gjelbër vinte pikërisht nga Albanian Skills, përkundër një organizate mjedisore siç mund të imagjinohet kur flasim për fusha dhe tematika të tilla.

I dashur lexues, tranzicioni i gjelbër kap në thelb çdo aspekt të jetës sonë. Problemet e epokës ku po jetojmë, po bëhen gjithnjë e më evidente. Ndërsa deri dje nocioni i ndryshimeve klimatike na dukej dicka e largët dhe e paprekshme, sot bëhet e qartë se probleme të tilla në fakt po rrezikojnë çdo gjë duke filluar nga ushqimi, nga shëndeti i njeriut në mënyrë të drejtpërdrejtë (me përhapjen e sëmundjeve apo edhe për shkak të temperaturave shumë të larta), nga uji dhe mungesa e tij etj.

Ajo që i bashkon të gjitha keto probleme me njëra tjetrën, është zgjidhja: tranzicioni i gjelbër. Tranzicioni i gjelbër do të thotë që ne të ri-koceptojmë mënyrën si prodhojmë energji, se si prodhojmë të mira dhe se si konsumojmë, ekonominë dhe zinxhirin e saj të vlerës, industrinë, transportin, ndotjen, prodhimin bujqësor, trajtimin e burimeve ujore etj. Tranzicioni i gjelbër do të thotë të adresojmë në mënyrë të menjëhershme ndryshimet klimatike dhe degradimin e mjedisit, të cilat tashmë janë një kërcënim ekzistencial. Tranzicioni i gjelbër nuk është më një zgjedhje, por është tashmë, e vetmja zgjidhje. Si e tillë, kërkon një gjeneratë të re, të pajisur me aftësi të gjelbra të cilat të mund të përballojnë sfidat e të ardhmes në aspektet e sipërpermendura, dhe kjo për mendimin tim mbetet sfida më e vështirë prej të gjithave, pasi kërkon një ndërgjegjësim rrënjësor të kësaj gjenerate për të kuptuar rëndësinë së pari të nevojës së kësaj epoke për profesionistë të tillë, përpos faktit që kërkon njerëz me aftësi analitike shumë të mira, dhe “zgjidhës problemesh” më shumë se sa çdo gjë tjetër.

Lexim të këndshëm në vijim!

©AlbanianSkills

NË KËTË NUMËR:

**TRANZICIONI GJELBËR-
FRANÇESKA KORANÇE**

**VIZITE E AMBASADORES
AMERIKANE JURI KIM GJATE
NJË AKTIVITETI TE ZYRËS PËR
INFORMIM DHE KËSHILLIM
KARRIERE – BASHKIA KUKËS**

**TAKIMI PRANVEROR MBI
KARRIEREN E TË RINJVE
BASHKITË MAT, KUKËS, DIBËR
15-17 PRILL 2022**

**DITA NDËRKOMBËTARE TË
VAJZAVE NË TIK"**

**AKTIVITETET E PROJEKTTIT
INTERVET**

- PRAKTIKE PUNE E MËSUESVE, HOLLANDË
- LËVIZSHMËRIA AFATSHKURTËR E STUDENTËVE
- SESION TRAJNIMI PËR DREJTUESIT DHE KORDINATORËT E NJËSIVE TË PROJEKTEVE PRANE SHKOLLAVE AFP SHQIPËRI
- PREZANTIMI GJATË JAVËS EUROPËS NË SHQIPËRI

**JAVA E AFTËSIVE SHQIPTARE
2022**

- TRANZICIONIN E GJELBËR DHE SI TË RIORIENTOJMË SISTEMET TONA TË AFTËSIVE NË PËRPUTHJE ME AMBICIET E GJELBRA?
- SIGURIA USHQIMORE
- EDUKIMI PËR TRANZICIONIN E GJELBËR, PUNËT DHE KARRIERA-UADM DHE UNIVERSITETI POLIS
- "ETF RRJETI PËR QENDRA TË EKSELENCËS -SISI: SHPËRNDARJA E INNOVACIONIT NË PËRFSHIRJEN SOCIALE PER HERE TE PARE KONKURSI MBI TURIZMIN NE ITE-DAYS EXPOCITY ALBANIA

AKTIVITET E ARDHSHE

VIZITË E AMBASADORES AMERIKANE JURI KIM GJATE NJË AKTIVITETI TE ZYRËS PËR INFORMIM DHE KËSHILLIM KARRIERE – BASHKIA KUKËS

Fuqizimi i të rinjve dhe aftësive të tyre për karrierën profesionale dhe fuqizimin e komunitetit përmes rrjetëzimit personal dhe profesional ishte tema e aktivitetit ditën e Martë më datë 13 Prill, ora 16:00-17:00 pranë Bashkisë Kukës.

Ky ishte workshopi i parë i ‘Takimit Pranveror mbi Karrierën e të Rinjve’ që u realizua në datat 15-17 Prill në kuadër të projektit “Një vizitë larg karrierës tuaj të ardhshme” të financuar nga Zyra për Marrëdhënien me Publikun të Ambasadës së SHBA-së në Tiranë dhe zbatuar nga Albanian Skills në bashkëpunim me Bashkinë Kukës, Dibër dhe Mat.

Pjesëmarrës në këtë takim ishin: Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës Yuri Kim, Zëvendës Shefja e Marrëdhënies me Publikun Amanda Roberson dhe nënkryetarja e Bashkisë Kukës Znj. Majlinda Onuzi. dhe punonjës të Bashkisë Kukës; Koordinatorja lokale Znj. Vera Istrefi; Znj. Ana Zacharian- Kryetare e Shoqates dhe Drejtore Ekzekutive Albanian Skills dhe stafi i organizates; të rinj dhe të reja pjesëmarrës në Akademinë e Karrierës dhe aktivitete të tjera të projektit.



Workshopi filloi me një prezantim të projektit, hapave të cilat janë ndërmarrë deri tani dhe mënyrën e funksionimit të zyrës në Bashkinë e Kukësit, aktivitetet të cilat kanë mbetur për t'u realizuar, sfidat që janë hasur etj.

Më pas vijoi me diskutim, reflektim dhe dhënie mendimesh nga pjesëmarrësit, kryesisht ndërmjet Znj. Ambasadore dhe të rinjve të zonës. Znj. Ambasadore në fjalën e saj shprehu kënaqësinë e të qenurit prezente, i motivioi dhe i përgëzoi të rinjtë dhe stafin për hapjen e zyrës edhe aktivitetet që kanë realizuar duke i inkurajuar për aktivizmin e tyre në përgjigje të sfidave dhe problemeve me të cilat përballen komunitet ku jetojnë. Gjithashtu dhe të rinjtë shprehën mendimet e tyre për aktivitetet e realizuar, sa efektive dhe ndihmuese janë dhe se çfarë do të donin që të realizohej më tej.

Zj. Entela Gjyla- Kërkuese Shkencore pranë organizatës Albanian Skills realizoi një lojë rrjetëzimi “Bussines Card” për të nxitur komunikimin dhe ndërveprimin ndërmjet të rinjve pjesëmarrës. Me anë të kësaj loje u arrit që të shiheshin benefitet e krijimit të rrjetëzimit, strategjive të vogla, dhënies së informacioneve, nëpërmjet të cilave të rinjtë mund të krijojnë një rrjetëzim që u shërben në të ardhmen.

Workshopi u mbyll me fjalën e Znj. Ana Zacharian e cila i falenderoj të gjithë pjesëmarrësit për prezencën e tyre dhe i motivoi të rinjtë për pjerësmarrje në sa më shumë aktivitete të tilla dhe vijueshmërinë e mëtejshme të Zyrës së Karrierës.



TAKIMI PRANVEROR MBI KARRIEREN E TË RINJVE 15-17 PRILL 2022, BASHKITË MAT, KUKËS, DIBËR

Në kuadër të projektit 'Një vizitë larg nga karriera juaj e ardhshme' si dhe për të realizuar përmbylljen e tij u zhvillua "Takimi pranveror mbi karrieren e të rinjve". Projekti është financuar nga Programi për Demokraci i Departamentit të Shtetit të SHBA-ve dhe po zbatohet nga Albanian Skills në bashkëpunim të ngushtë me tre Bashkitë, Mat, Dibër dhe Kukës gjatë periudhës Korrik 2021-Prill 2022. Qëllimi i këtij projekti ishte fuqizimi i të rinjve, vajzave dhe djemve, me aftësitë e nevojshme për tregun e punës, duke promovuar vetë-punësimin, sipërmarrjen dhe ndërgjegjësimin e biznesit për punësimin e të rinjve. Për të ofruar shërbimet e mësipërme në secilën bashki janë hapur 'Zyra për Informin dhe Këshillim Karriere', të cilat administrohen nga bashkitë përkatëse.

Për pjesëmarrjen në këtë aktivitet u ftuan të aplikonin 136 të rinj, dhe u morren 74 aplikime nga të treja zonat Mat, Kukës Dibër, ku u përzgjedhën 40 të rinj të cilët ishin pjesëmarrës aktiv përgjatë zbatimit të projektit, akademisë së karrierës, sesioneve të mentorimeve si edhe aktiviteteve të zhvilluara prej tij. Të rinjtë e përzgjedhur realizuan një udhëtim të përbashkët tre ditor me nisje nga Kukësi, ndalesë në Burrel, në Peshkopi dhe duke e përfunduar në Kukës.

Qëllimi i këtij udhëtimi ishte të realizohej një shkëmbim rinor ndërmjet të rinjve të të treja bashkive, shoqërizimi ndërmjet tyre, ndarja e eksperiencave dhe përvojave të tyre, hartimi i kalendareve të shërbimeve të karrierës për çdo bashki si edhe diskutimi i nismave për të forcuar komunikimin dhe rrjetëzimin e tyre me fokus karrierën e të rinjve .




Shkëmbimi filloi në datën 15 Prill ku të rinjtë e Bashkisë Kukës u takuan sëbashku me stafin e Albanian Skills dhe udhëtuan për në Burrel. Në sallën e Këshillit Bashkiak Mat u pritën nga të rinjtë matjane, ZIKK Mat dhe nënkryetari i Bashkisë Mat e ku realizuan:

- Vizitë tek "Zyra për Informim dhe Këshillim Karriere"
- Urimi i mirëseardhjes nga Zv.Kryetari i bashkisë Mat Z. Myslym Zeneli,
- Prezantim i Videos- promovuese të Vlerave Ekoturistike të Matit nga të rinjtë.
- Diskutim midis të rinjtëve në lidhje me të studiuarit në një shkollë profesionale apo në universitet.
- Vizitë tek Muzeu Historik Mat, ku të ftuarit do të njihen me historinë e Matit

Pas përfundimit të takimit në qytetin e Burrelit, sëbashku me gjithë informacionin e marrë me vete dhe dashamirësinë e banorëve dhe të rinjve të kësaj Bashkie u realizua nisja për në qytetin e Peshkopisë. Pasi mbërritjes në qytet u bë akomodimi në hotel i të gjithë pjesëmarrësve. Të rinjtë u mirepritën nga ekipi i ZIKK Dibër dhe të rinjtë dibranë të cilët darkuan sëbashku. Më pas u realizuan sesionet ushtrimore me të rinjtë të cilët u njohën me njëri-tjetrin dhe shkëmbyen informacione të ndryshme përmes ushtrimeve të realizuara në grup.



Dita e dytë 16 Prill nisi plot energji dhe entuziazëm nga të gjithë të rinjtë dhe stafin organizues. Fillimisht nisi me njohjen e “Zyrës për Informim dhe Këshillim Karriere” dhe mireseardhja urura nga ekipi i ZIKK Dibër dhe Z. Ruzhdi Deda, NënKryetarin e Bashkisë Dibër, i cili shprehu falenderimet për projektin dhe nenvizuar rëndësinë e këtyre shkembimeve rinore. Pas këtij takimi të rinjtë realizuan një vizitë në muzeun historik Dibër ku u njohën me historinë e këtij qyteti.



Më pas pjesëmarrësit u nisën drejt qytetit të Kukësit. Pasi u bë sistemimi në hotel filloi seanca e tretë ushtrimore me të rinjtë. Të gjithë të pranishmit u njohën me “Kukesin e Ri” filmi dokumentar dhe zhvilluan një diskutim dhe reflektim për aktivitetet e realizuara dhe ide konkrete për vijueshmërisë e rrjetëzimit të të rinjve të këtyre tre bashkive.

Pjesëmarrësit u ndanë në 6 grupe, 5 grupe përbërë nga të rinjtë, dhe punuan në grupe mbi propozime dhe ide se si të mbahet dhe forcohet një rrjetëzim aktiv mes tyre dhe ZIKK. Ndërsa grupi i gjashtë i përbërë nga kordinatorët lokale të të treja bashkive dhe stafet e ZIKK diskutuan dhe reflektuan mbi disa aktivitete konkrete për të përmirësuar dhe mbajtur aktive ZIKK.

Më pas një vizitë në Muzeun Etnografik Kukës dhe shëtitje përgjatë Turizmit të Vjetër me pamje të mrekushhueshme panoramike të Malit Gjallicë dhe Liqenit të Fierzës përmyllën aktivitetet e ditës, duke i lënë të rinjtë të darkonin sëbashku, kërcenin dhe këndonin. Të Dielën në mëngjes, ora 10:00 të gjithë të rinjtë u nisën për në qytetet e tyre duke marrë me vete përshtypjet më të mira nga ky udhëtim i cili do të mbahet mend gjatë.



Ky shkëmbim i realizuar si përmyllje e projektit u bëri të mundur të rinjve të njihnin më shumë me kulturat, traditat dhe historinë e secilit prej qyteteve. Pjesëmarrësit u lidhën më shumë me njëri-tjetrin, bashkëpunuan dhe mësuan më shumë; u ushtruan me anë të seancave ushtrimore por dhe u kënaqën e argëtuan pafund. Aktivitete të tilla janë një përvojë dhe eksperiencë më vetë, shija dhe mbresat që na lanë nga të rinjtë e të treja Bashkive pjesëmarrëse ishte fantastike e cila do të mbesë gjatë në memorien e gjithë secilit prej pjesëmarrësve dhe nuk do të mund të realizohej suksesshëm pa mbështetjen e përhershme të ekipeve të Bashkive Mat, Dibër dhe Kukës dhe kordinatorëve lokale të projektit.



"DITA NDËRKOMBËTARE TË VAJZAVE NË TIK"

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Vajzave në TIK, Albanian Skills ju bashkua aktiviteteteve dhe eventeve mbarëbotërore, të cilat që prej vitit 2011, kanë përfshirë 377,000 vajza, në më shumë se 11,400 aktivitete ndërkombëtare në 171 vende të botës. Në këtë rrugëtim 10-vjeçar të kësaj dite, le të kontribuojmë të gjithë së bashku për të sjellë frymën e kësaj nisme edhe në vendin tonë e ta shtojmë Shqipërinë në hartën globale të vendeve që mbështesin fuqimisht vajzat në TIK! Ashtu sikurse edhe natyra e objektivave të kësaj lëvizjeje globale, edhe në Shqipëri vajzat do të jenë protagonistet e kësaj dite. Në një panoramë të përgjithshme, aktivitetet që synojmë të zhvillojmë në Shqipëri, targetojnë vajzat në të gjitha Shkollat e Arsimit të Mesëm në Shqipëri, duke i shtirë objektivat në dy drejtime kryesore:

- Mbështetja e vajzave në Shkollat e Mesme të formimit të përgjithshëm të njohin dhe të punojnë më nga afër mjetet dhe programet dixhitale krijuese, duke nxitur dëshirën dhe interesat e tyre për të konsideruar një karrierë të ardhshme në këtë profil.

- Zgjerimi dhe përforcimi i aftësive dhe kompetencave dixhitale të vajzave në Shkollat e Arsimit Profesional, përmes një mundësie unike për të vënë në jetë idetë e tyre krijuese dhe inovative për të ardhmen.




Këtë vit në eventit "Albanian Girls in ITC" aplikuan mbi 130 vajza të cilat kishin njohuri rreth teknologjisë por dhe vajza të cilat nuk kishin njohuri rreth teknologjisë.


Përgjatë datave 18-20 Prill u realizuan sesione informuese, trajnuese nga ekspertë të fushës së ITC në vendin tonë, ku vajzat morën dhe informacione, u njohën dhe në mënyrë praktike, konkrete me aspekte të teknologjisë.

Ekspertët propozuan tematika të ndryshme ku vajzat përzgjedhën një ose më shumë nga ato të cilat i punuan përgjatë datës 21 Prill.

Sesionet ishin mjaft interesante, të vlefshme dhe një shtysë për të gjitha vajzat të cilat janë pjesë e kësaj fushe por jo vetëm që teknologjinë ta bëjnë pjesë të studimeve dhe eksperiencave të tyre. Ekspertët pjesëmarrës që realizuan sesionet informuese por dhe vlerësuan punën e vajzave ishin:

1. Klodiana Ndou- Expert Digital Advertiser
2. Renata Kadiu- Senior Ux/UI Designer
3. Danjel Docci- 3D Artist Co-Funder NesHawk
4. Ermonela Metushi- Web Development Leeto Digital Agency
5. Edison Biba- Co Funder Leeto Digital Agency
6. Uendi Cerma- Eksperte dhe Konsulente IT & Multimedia Universiteti Aleksander Moisiu
7. Ornela Rrustaj-GDSC Lidere për UAMD dhe Shqipërinë, Universiteti Aleksander Moisiu
8. Albina Tocila- Zëvendëse Dekane e Fakultetit të kërkimit dhe zhvillimit; Kordinatore e Programimit të shkencave Kompjuterike Universiteti Poliss
9. Dhurata Shehu- Asistenete Lektore Universiteti Poliss
10. Melisa Tufa- Asistente Lektore Universiteti Poliss





Gjatë pasdites, 22 Prill në mjediset e Micro Folie Tirana, me pjesëmarrje fizike dhe virtuale të vajzave pjesëmarrëse, duke prezantuar punët e tyre u realizua dhe mbyllja e kësaj jave intensive por dhe shumë të bukur e të vlefshme për të gjitha vajzat.

Edhe gjatë këtij viti, vajzat treguan se mundën të kenë një karrierë profesionale të sigurt dhe të suksesshme në teknologji, prandaj motivimi dhe inkurajimi i tyre duhet të vijojë vazhdimisht derisa ato të fitojnë besimin e duhur në zgjedhjen e teknologjisë si një mundësi shumë e mirë arsimimi dhe punësimi.



AKTIVITETET E PROJEKTIT INTERVET WB

Job Shadowing i mësuesve në Hollandë

Miratuar në vitin 2019, projekti INTERVET WB do të lejojë 54 mësues ose staf/menaxher administrativ nga të gjitha shkollat e AFP-së të 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor (Shqipëri, Kosovë, Mali i Zi, Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Bosnja) të kryejnë një stazh 7 ditor jashtë vendit. Mësuesit e përzgjedhur udhëtuan drejt Hollandës ku patën një eksperiencë ndryshe në kompanitë atje.



Pas udhëtimit në Hollandë mësuesit janë akomoduar dhe kanë filluar eksperiencën e tyre pranë Kolegjit Da Vinci. Kjo eksperiencë ishte shumë e vlefshme për mësuesit e shkollave profesionale pasi atje panë nga afër një ambient tjetër, metoda të tjera të mësimdhënies, atashimi me nxënësit etj. Më poshtë mund të lexoni disa nga dëshmitë e tyre.



"Përgjatë kësaj eksperience, përfitova shumë, në shumë elementë, duke filluar nga Korniza e Kualifikimeve, hartimi i kurrikulave, mënyrat e metodat e mësimdhënies, komunikimi ndërsjelltë, dashamirësia, këmbëngulja, durimi, profesionalizmi, në zgjidhjen e problemeve, mënyra e vlerësimit, etj. Elementë të didaktikës së mësimdhënies në institucionet e AFP të zbatuara nga mësimdhënësit tanë, i vura re të ngjashme, në orët e mësimi ku asistova. Sigurisht ka elementë të infrastrukturës së arsimit profesional në kolegjin Da Vinci që bëjnë diferencën, si: mjediset ku zhvillohen orët teorike e praktike, baza materiale digitale e shumëllojshme, numri i vogël i nxënësve në klasa, mjediset shplohëse, mënyra e frekuentimit të mësimi, numri i lartë i nxënësve me aftësi të vecanta (special needs), frekuentues të këtij arsimit, përfshirja dhe zhvillimi i praktikave profesionale pranë biznesit në moshën 16 vjeçare, zhvillimi intership-it, të gjitha këto hap pas hapi. Interesant roli i ambasadorëve të shkollës, të cilët përfaqësojnë nxënësit të kolegjit, të cilët merreshin me organizime eventesh, informime, ndjekje problemesh mes tyre. Vura re se përdorimi i quiz - eve në orë të mësimi, përdorimi internetit për kërkimin e informacionit, zhvillimi i krijimtariisë së studentëve, duke bërë ata vetë, sillte interes më të lartë, si dhe siguron cilësi në mësimdhënie e vlerësim. Edhe pse i përdor këto mënyra, mendoj t'i përdor më dendur, për të rritur konkurrencën, shpirtin krijues, bashkëpunimin, përdorimin e paisjeve digitale. Sigurisht kjo eksperiencë ka ndikuar mjaft në mësimdhënien time, në artikulum, qëndrim e komunikim. Jemi më të buzëqeshur, më të ciluruar, më entusiazatë me studentët tanë, duke i përsëritur shpesh, se kështu zhvillohej edhe në Hollandë."



Vojsava Deliaj, Shkolla e Mesme Profesionale "Ali Myftiu"



Klodiana Memelli Shkolla "Salih Ceka"

"Kam përfituar shumë si nga ana personale ashtu dhe nga profesionale në aspektin e mësimdhënies.

Gjëja e parë që më bëri përshtypje ishte përshëndetja e njerëzve kudo në rrugë dhe pse nuk me njihnin mua personalisht. Ishte gjë shumë e bukur se u ndjeva komode dhe pse në një vend të huaj.

Kolegji Da Vinci ishte një campus ideuar dhe ndërtuar sipas karakteristikave e ngjyrave të Da Vincit. Dixhitalizimi i kësaj shkolle, lirshmëria dhe pavarësia e mësuesit në organizimin e orës mësimore sipas nivelit e numrit të nxënësve dhe përgjegjësia e vete nxënësve për orën e mësimi apo dhe puna me nxënësit të veçantë me probleme në arritjen e nivelit baze të mesuarit janë gjerat që do të veçoja nga ky Job Shadowing.

Njëkohësisht peisazhi, pastëria dhe kultura holandeze vihej re kudo që ti shkoje, ishte thjesht mahnitëse."

1-Kjo eksperiencë ishte frytdhënëse, e domosdoshme dhe e arrirë për qëllimin që mbarte në vetvete.

2-Në këtë eksperiencë përfituam goxha shumë duke filluar që nga mënyrat e menaxhimit të oreve mësimore, komunikimit, vlerësimit, bashkëpunimit në grup, lirshmërisë të të punuarit, qetësisë dhe relaksit që të trasmetonin të gjithë.

3-Gjëja që më ka bërë më përshtypje tek kolegji Da Vinci që gjente forma për të mesuar dhe punuar dhe për fëmijët në nevojë (nevoja speciale).

4-Përfituam goxha njohuri të reja që nga mënyra e vlerësimit, realizimi i orëve, kuizet, dhënia e një projekti ndarja e viteve në nivele etj. Mendoj që një orë të tillë mësimore sigurisht me ndihmën e shkollës ta realizoj dhe me nxënësit e mi.

5-Kjo eksperiencë ndikoi patjetër dhe në të ardhmen në mësimdhënien time por me pak durim dhe kohë sidomos për aftësitë e buta.



Dorina Nikaj Shkolla Tregtare Industriale; Qendra e Formimit Profesional Publik Vlorë



"Këtë eksperiencë ua kam sugjeruar patjetër kolegëve të mi, sepse duhet të kemi modelin e një shkolle e kolegji fitimtare, me i miri në Europë e të përafrohemi me rezultatet e me modelin të kolegjeve si Da Vincit në të gjitha drejtimet që duhet të ketë një shkollë e arsimit profesional.



INTERVET WB LËVIZSHMËRIA E NXËNËSVE


Lëvizshmëria e nxënësve në praktikë njëmuajore dhe tremujore

Miratuar në vitin 2019, projekti INTERVET WB do të lejojë 360 studentë nga të gjitha shkollat e AFP të 6 shteteve të Ballkanit Perëndimor (Shqipëri, Kosovë, Mali i Zi, Serbi, Maqedonia e Veriut dhe Bosnje) të kryejnë një praktikë 1 Muajore jashtë vendit dhe 56 nxënës me praktikë Tremujore.


Pas udhëtimit në Spanjë dhe Itali ata u vendosën në kompanitë përkatëse ku ndoqën praktikën për një muaj. Pjesë e kësaj praktike ku nxënësit e AFP-së në fushën e IT, Turizmit, Gastronomisë, Elektronikës, Ndërtimit dhe Administrimit. Këto praktika ishin shumë të suksesshme për studentët, duke marrë vlerësime dhe reagime shumë pozitive nga kompanitë ku ata punonin. Më poshtë mund të lexoni disa nga dëshmitë e vetë studentëve të cilët ishin pjesëmarrës në mobilitete.

Në praktikën time tremujore në Itali kam punuar si receptionist në një hotel që quhej “Hotel degli Arcimboldi”. Puna që kam kryer ka zgjatur 6 orë e 30 minuta, 5 ditë të javës, nga të cilat 30 minuta i kushtoheshin pushimit të drekës, me turne të ndryshme. Në ditën e parë menaxheria e hotelit na njohu me etikën dhe rregullat e hoteli, që duhet të ndiqnim në vendin e punës. Ditën e dytë fillova praktikën normalisht. Gjatë javëve të para isha i vëmendshëm dhe mbaja shënime në lidhje me procesin e punës. Kolegët atje më shpjegonin me hollësi procesin e punës dhe më jepnin detyra të lehta për të kryer. Veprimet dhe rregjistrimet që ndodhnin në hotel pasqyroheshin në programin hotelierik “Protel”. Programi ishte në gjuhën italiane kështu që e pata paksa të vështirë në fillim. Pas rreth 3 javësh ja arrita të memorizoj proceset e punës dhe se si funksiononte programi, gjë e cila u bëri përshtypje kolegëve, të cilët më pas filluan të më lejonin të punoja I pavarur. Gjatë kohës atje, vura re se përher kishte nga një rast të ri regjistrimi dhe procesi pune, por gjatë këtyre muajve unë zhvillova në hotel veprimtari nga më të ndryshmet të cilat përfshinin:

1. Rregjistrimin e dokumentave të klientëve në sistem
2. Regjistrimin e informacioneve të biznesit.
3. Regjistrimin e statusit të dhomave.
4. Kontrollin e rezervimeve.
5. Sistemimin dhe organizimin e dokumentacioneve etj



Mario Dhimitri Shkolla
Teknike Ekonomike, Tirane




Anjeza Rama Shkolla Salih
Ceka, Elbasan

Mjaft të rëndësishm në lidhje me eksperiencën që nxënësit kanë kaluar në Mobilitete janë dhe mendimet, përshtypjet e vetë prindërve të nxënësve. Fabio Meko ishte një nga nxënësit I cili ishte pjesëmarrës në një nga Mobilitetet e realizuar dhe babai I tij gjatë një komunikimi me të ka shprehur mendimin e tij në lidhje me eksperiencën që ka kaluar djali I tij.



Përhëndetje unë jam babai i Fabios një nga nënësit që ka marrë pjesë në praktikë jashtë vendit. Eksperienca e Fabios për ne si prindër ishte një eksperiencë e re por dhe mjaft e bukur pasi i shërbeu Fabios jovetëm nga ana mësimore e profesionit që ai ka zgjedhur por dhe se si të përshtatet në një ambient pune, në një vend të huaj të panjohur me të, si të ambjentohet atje dhe të ndihet pjesë e atij vendi për aq kohë sa ai qëndroi atje. Gjithashtu u bindëm që Fabio është një djalë me këmbë në tokë dhe i zoti që të ecë përpara të përballet me të gjitha sfidat që do t'i sjellë jeta. Faleminderit për këtë eksperiencë kaq të bukur që djali ynë pati mundësi të kalonte.



**Fabio Meko Shkolla Teknike
Ekonomike, Tirane**

SESIONE TRAJNIMI

INTERVET Western Balkans është një projekt pilot 3-vjeçar për ndërkombëtarizimin e sistemeve të arsimit dhe formimit profesional në Ballkanin Perëndimor, i cili synon krijimin e mundësive për lëvizshmërinë e të mësuarit në institucionet e arsimit profesional të Ballkanit Perëndimor dhe përmirësimin e kulturës së lëvizshmërisë për të mësuarit në fushën e AFP-së.

Në kuadër të INTERVET WB, Uniser, koordinatori i projektit Intervet WB dhe partneri i projektit Albanian Skills në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA) më datë 26 Prill në orën 10:30-13:00 zhvilluan për anëtarët e njësive të zhvillimit dhe drejtuesit e institucioneve të arsimit profesional në Shqipëri si edhe përfaqësues të AKPA-së në Tiranë, trajnimin me temë “ Lëvizshmëria për të mësuarit përmes INTERVET WB dhe Erasmus+ 2021-2027 ” në një format të përzier pranë ambienteve të Shkollës Teknike Elektrike ‘Gjergj Canco’, Tirana dhe online përmes platformës Zoom.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte njohja me procesin e “lëvizshmërisë” së nxënësve dhe mësuesve, procedurat dhe proceset e përdorura nga INTERVET (gjatë mobiliteteve) si edhe mundësitë që ekzistojnë për të planifikuar dhe organizuar lëvizshmërinë e të mësuarit nga vetë institucionet e arsimit dhe formimit profesional në kuadër të Programit Erasmus+ 2021-2027 por edhe në kuadër të mekanizmave të ndryshëm të ofruara nga Bashkimi Europian.

Përfaqësuesja nga Uniser dhe koordinatore e Intervet për Shqipërinë, Gulia Quaglietti prezantoi në mënyrë konkrete:

Njohja me projektin Intervet dhe objektivat e tij

Rezultatet e deri tanishme

Proçesi aplikimit (diskutim i hapur me pjesëmarrësit)

Proçesi i përzgjedhjes

Trajnimi i para-nisjes- Si të përgatisësh një nxënës / student/ për një përvojë lëvizshmërie

Organizimi i të mësuarit gjatë lëvizshmërisë

Njohja dhe Vlerësimi


Njohjen me programet e Erasmus +

Rëndësia e programeve Erasmus+ për institucionet e AFP-së, nxënësit dhe ekipet e tyre



Për t'u shënuar janë interesim i lartë i shfaqur nga pjesëmarrësit lidhur me ngritjen e kapaciteteve të institucioneve AFP-së për përfshirjen e tyre në projektin INTERVET WB dhe thirrjet e Erasmus+ si edhe eksperiencat dhe vlerësimet që u ndanë prej mësuesve pjesëmarrës në Punë në Hije/ Job Shadowing por dhe të nxënësve të tyre pjesëmarrës në praktikat profesionale jashtë vendit në kuadër të INTERVET WB. Ato u shprehën se eksperiencat e tyre mbeten mjaft të vlefshme, dhe sic u shpreh dhe njëra nga mësueset duke e konsideruar si “një përvojë jetësore”. Lëvizshmëria në një nga vendet pritëse i ka vlejtur shumë pasi nëpërmjet saj kanë arritur që të shikojnë një realitet ndryshe, të reflektojnë për punën e tyre por dhe të pasurohen me metoda të ndryshme mësimdhënëse të cilat po i aplikojnë dhe në shkollat e tyre.

INTERVET WB do të vijojë punën dhe angazhimin për ngritjen e kapaciteteve të sistemeve të AFP-së lidhur me lëvizshmërinë e nxënësve, mësuesve dhe drejtuesve të institucioneve arsimore si një kontribut i çmuar në proceset e ndërkombëtarizimit të sistemeve APF të Ballkanit Perëndimor.



JAVA EUROPËS NË SHQIPËRI

Çdo vit në vendin tonë “Java e Europës” mbahet nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri... këtë vit java ka në fokus vlerat e Bashkimit Evropian. Vlerat evropiane u konfirmuan edhe një herë: respektimi i dinjitetit njerëzor, liria, demokracia, sundimi i ligjit, respektimi i të drejtave të njeriut, mosdiskriminimi, solidariteti dhe barazia midis grave dhe burrave. Gjithashtu u vunë në pah vlerat e vendit tonë, traditat e qyteteve, mikpritja, kultura, turizmi dhe mundësitë për të ardhmen.



Fillimi i aktiviteteve më 3 maj 2022 nga qyteti i bukur i Shkodrës shënoi një pjesëmarrje shumë të madhe. Më pas, aktivitetet e javës u zhvendosën pranë Lungomares në qytetin e Vlorës më 5 maj për të përfunduar më 9 maj në qytetin e Tiranës pranë pedonales së qytetit.

Morën pjesë organizata dhe projekte të ndryshme, artizanë, ambasada, universitete etj., të cilët gjatë gjithë ditëve të aktiviteteve shpalosën për të ftuarit dhe qytetarët informacione, njohuri të ndryshme mbi programet dhe projektet e financuara nga Bashkimi Evropian në Shqipëri, etj.

Projekti INTERVET BB u prezantua në një stendë të veçantë si dhe të gjitha programet dhe projektet e financuara nga Bashkimi Evropian në Shqipëri.

Gjatë prezantimeve të kësaj jave ka pasur interesim të qytetarëve, prindërve dhe nxënësve të institucioneve të arsimit profesional për t'u njohur me projektin INTERVET BB, aktivitetet e tij si dhe histori të ndryshme nga jeta dhe puna e nxënësve të ndryshëm që kanë përfunduar tashmë mobilitetin. . për mësimin në vende të ndryshme të BE-së si dhe me thirrjet e reja të mobilitetit për mësim që do të ndodhin gjatë periudhës së zbatimit të këtij projekti.

Pati edhe argëtim, shfaqje filmash, dokumentarësh dhe muzikë, duke sjellë entuziazëm te pjesëmarrësit.



JAVA E AFTËSIVE SHQIPTARE

Aktivitetet përgjatë gjithë javës

“Java e Aftësive” në Shqipëri është iniciuar nga Albanian Skills- Shoqata Kombëtare për Konkurse të Aftësive në 2018, frymëzuar nga Java Evropiane e Aftësive Profesionale e nisur nga Komisioni Evropian. Që atëherë, Java Shqiptare e Aftësive organizohet çdo vit duke përfshirë dy vitet e pandemisë dhe këtë vit do të mbahet edicioni i 5-të në të njëjtën javë Javën Evropiane të Aftësive Profesionale 2022 dhe me të njëjtin slogan *#Skills4GreenTransition*; **“Merr trastën me vete”**




Siç tregohet nga katër vitet e fundit, njëqind ngjarje që janë realizuar gjatë javëve të dedikuara të aftësive javë të mbushura me aktivitete, seminare, trajnime, ngjarje të ditëve të hapura, konkurse aftësish etj, patën ndikim të madh në promovimin e aftësive për të gjithë, fëmijë, të rinj, dhe të papunë, institucione, projekte, organizata fokusi i të cilave ishte pasioni për profesione dhe aftësi në zanate të ndryshme, aftësi për jetën, aftësi për të ardhmen, aftësi për jetë elastike, punë të denjë dhe të drejtë etj.

Java e Aftësive 2022 në Shqipëri inicioi si një udhëtim i gjerë diskutimi dhe reflektimi me fëmijët dhe të rinjtë rreth marrëveshjes së gjelbër për zhvillim të qëndrueshëm, edukim për aftësi dhe karrierë.



Gjatë tranzicionit të gjelbër si sektori më i fuqishëm për të adresuar sfidat mjedisore me të cilat përballlet planeti, për të mbështetur objektivat e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs), tranzicionin e gjelbër si dhe nismën e Marrëveshjes së Gjelbër të Bashkimit Evropian. Të gjitha këto përmes forumeve për fëmijë dhe seminareve në laboratorët e Microfolie Tirana, Universiteti i Durrësit dhe Universiteti Polis. Fjala kyçe e kësaj jave do të jetë, ruajeni tokën, kujdesuni për ndotjen e ajrit dhe ujit, sektorin e mbetjeve dhe ushqimit, modën dhe energjinë, etj.

Java nisi me një webinar mbi: **Tranzicionin e gjelbër dhe si të riorientojmë sistemet tona të aftësive në përputhje me ambiciet e gjelbra?** Përgjatë këtij webinar morën pjesë ekspertë evropianë dhe shqiptarë të mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe praktikanët të arsimit, përkatësisht:

- Zoti. Romain Boitard, ETF - Ekspert i Zhvillimit të Kapitalit Njerëzor të Fondacionit Evropian të Trajnimit – Ndërlidhës me Vendin për Marokun dhe Shqipërinë
- Znj.Franceska Korance, Studiuese dhe Pedagoge e Mjedisit dhe Urbanistikës në Universitetin Polis
- Znj. Katerina Marku, Këshilli Bashkiak i Tiranës, Themeluese e platformës “Këshilli i Mjedisit të Tiranës”,
- Zoti. Louis Aquilina, Drejtor i MCAST, Zyra e Projekteve dhe Lëvizshmërisë Erasmus+
- Znj. Ana Mino, Shkolla Mihal Shahini” Shkolla AAP, Koordinatorë e Projektit



Ekspertët ndanë pikëpamjet e tyre mbi Qëndrueshmërinë e Gjelbërimit dhe SDG-të në AFP, sesi tranzicioni i gjelbër do të ndikojë në tregjet e punës brenda dhe jashtë BE-së, madje do të diskutuan për rastin shqiptar, duke treguar tranzicionin e energjisë, si të formësojmë brezin e ardhshëm me aftësitë e gjelbra dhe dixhitale, si një paradigmë e rëndësishme për ambicien tonë të së ardhmes së gjelbër dhe ndarjen e praktikave të mira të shkollave profesionale në gjelbërimin e AFP-së në Shqipëri.



Siguria Ushqimore

Më pas vijoi me aktivitetin për Sigurinë Ushqimore i cili u realizua në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit; Food Safety Project pranë ambjenteve të shkollës Konferenca e Pezës. Me pjesëmarrjen e Yllka Allara- Përfaqësuese e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit Tiranë; Valbona Lasku; Furrari- Communicator Food Safety; mesues të shkollës Konferenca e Pezës. Përgjatë këtij aktiviteti nxënësit diskutuan rreth ushqimit të shëndetshëm, mbetjeve ushqimore, tranzicionit të gjelbër, kujdesi që duhet të tregojmë gjatë konsumimit dhe blerjes së një produkti, leximit të etiketave, aftësitë që kërkohen për punë dhe karrierë gjatë tranzicionit të gjelbër. Specialistë të Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe AlbanianSkills prezantuan informacione, raste konkrete, risi në lidhje me këtë fushë. Gjithashtu aktiviteti certifikoi nxënësit pjesëmarrës në ciklin e trajnimeve mbi sigurinë ushqimore si "Ambasadorë të Sigurisë Ushqimore" nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.



2022,

Edukimi për tranzicionin e gjelbër, punët dhe karriera-UADM

Aktiviteti i radhës ishte me nxënësit e shkollës 9'vjeçare "Vincenc Prendushi" Durrës të cilët vizituan "Laboratorin Virtual" pranë Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës. Pjesëmarrësit përgjatë këtij aktivitetit ishin: Uendi Cerma- Eksperte dhe Konsulente e Multimedias; Marsida Ibros- Asiste Lektore pranë Universitetit; Mesues të Shkollës Vincens Prendushi.

Përgjatë kësaj vizite mjaft të këndshme dhe mirëpritëse nxënësit diskutuan dhe shprehën mendimet e tyre për sfidat dhe shkaktarët me të cilat po përballen planeti ynë gjatë sesioneve të ndryshme dhe përmes teknologjise VR.

Nxënësit punuan në grupe të vogla për të hedhur ide, rreth krijimit të një aplikacioni për reduktimin e ndotjes, dëmtimit të oqeanëve, ajrit, tokës mjaft frytdhënëse dhe të vlefshme.




Përjetuan një eksperience të re, ndryshe, me syzet VR të cilat ashtu sic u shprehën dhe vetë nxënësit e cila të fuste në një realitet ndryshe, më të prekshëm. Të parit e ndotjes, shkatërrimit të planetit tanë nëpërmjet syzeve bëri që të reflektonim më shumë dhe të bëhemi më të ndërgjegjshëm në ditët që vijojnë.



Përtej edukimit tradicional është motoja të cilën mirëpritëm një grup nxënësish në laboratorin më inovativ në Universitetin "Aleksandër Moisiu" në Durrës. Vtech and Innovation Hub përmes ekperiencës virtuale të bën të përfshihesh në një mjedis 360 gradë, ku ti mund të mësosh dhe ndërgjegjësohesh në të njëjtën kohë. Në fokus kishim ndotjen e mjedisit dhe në një laborator inovacioni, nxënësit dizenuan dhe prezantuan ide për aplikacione në realitetin virtual të cilat do të shërbenin për ndërgjegjësimin e moshatarëve të tyre dhe jo vetëm. Uendi Cerma- Universiteti Aleksander Moisiu

"ETF rrjeti për qendrat e ekselencës -SISI: shpërndarja e inovacionit në përfshirjen sociale- Shkolla e Mikpritjes dhe Turizmit në Tiranë" ishte aktiviteti i rradhë i cili u organizua nga ETF, më 18 maj në ambientet e Tirana International Hotel. Omologët shqiptarë, ETF dhe ENAIP organizuan vizitën e tretë on-line, pas asaj të parë të organizuar nga qendrat AMAL në Tel Aviv dhe të dytës të organizuar nga Tink Technology dhe Humanity College në Turqi. Ky takim ishte një mundësi për t'u ndjekur online nga CoVE të tjera të partneritetit SISI dhe shkollat shqiptare të AFP-së.



Pjesëmarrës, ekspertë në këtë aktivitet ishin:

Daniela Dal Zotto, menaxhere e projektit ndërkombëtar, ENAIP NET

José Manuel Galvin Arribas, Koordinator për Projektin e Përsosmërisë Profesionale, ETF

Lida Kita, Eksperte e Lartë për Zhvillimin e Kapitalit Njerëzor - Përfshirja Sociale - Ndërlidhëse e vendit për Izraelin, Serbinë dhe Turqinë, ETF

Ejvis Gishti (Shehi), Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Flutura Vaqarri, Drejtoreshë e Shkollës së Mikpritjes dhe Turizmit të CoVE të Tiranës

Maddalena Comincini, OeaD, Zyra e Bashkëpunimit Rajonal Shqipëri, Kosovë, Maqedonia e Veriut

Gid Shaqiri, GM në Hotel M.K

Juna Beqiri, menaxhere e burimeve njerëzore në Hotel Maritim Piazza

Eni Xheko, GM në Hotel Xheko Imperial

Arta Sino, Administratore e resortit Prestige

Denisa Meco, Drejtuese e Departamentit të Gjuhëve të Huaja,

Donald Vogli, mësues i AFP-së, ish-student

Besim Xhaja, Drejtues i Departamentit të Sigurimit të Cilësisë

Elmira Qerimaj, mësuese e ushqimit dhe pijeve

Voltisa Zerellari, studente

Filippo Del Ninno, Ekspert i Zhvillimit të Kapitalit Njerëzor - Ndërlidhës me Vendet për Moldavinë, ETF.

Gjatë kësaj vizite virtuale të pjesëmarrësve ishte një mundësi e shkëlqyer për të vëzhguar nga afër realitetin dhe punën e Shkollës së Mikpritjes dhe Turizmit CoVE të Tiranës përmes një pasqyre të përgjithshme të Shkollës të bërë nga drejtuesit e shkollës dhe e ndjekur nga prezantimi i një përzgjedhje e praktikave të mira në fushën e partneritetit të biznesit nga prezantime të ndryshme të bëra nga mësues, studentë, biznese të përfshira në mësimin praktik dhe ish studentë. Pjesa e dytë ishte një turne virtual në Shkollën e Mikpritjes dhe Turizmit CoVE Center të Tiranës dhe dëshmi të shkëlqyera nga studentët dhe ish-studentët tashmë të përfshirë në mënyrë aktive në procesin e mësimdhënies

Një diskutim interesant midis pjesëmarrësve vendas në sallë dhe anëtarëve të ENE nga vende të tjera përforcoi rëndësinë e praktikave më të mira të ndara midis COVE dhe sa i rëndësishëm është promovimi i përsosmërisë së AFP-së për të rritur përsosmërinë në të gjithë sistemet e AFP-së.



Edukimi për tranzicionin e gjelbër, punët dhe karriera-Polis University

Universiteti Polis mirëpriti nxënësit e shkollës 9 vjeçare "Ernest Koliqi" Tiranë. Trajnerë në këtë aktivitetet ishin:

Eralda Ribaj- Zyra e Marketingut dhe e Pranimeve

Samela Kruja- Lektore praën Departamentit të Mjedisit, në Universitetin Polis.

Edi Duro- Laborant pranë Universitetit Polis

Nxënësit u njohën me tranzicionin e gjelbërt, diskutuan për shkaktarët e ndotjes së planetit vizituan laboratorët e eficeses se energjisë dhe analizave te mjedisit ku mësuan shumë gjëra te reja dhe interesante në mënyrë praktike dhe konkrete lektoret dhe specialistet e Universitetit Polis.

Ishte një eksperiencë e dobishme e cila do të mbahet mend, pasi informacionet që u morën do t'i vlejne shumë fëmijëve në njohjen e mëtejshme të tranzicionit të gjelbër, ndikimi i tij në jetën dhe punët që do të bëjnë në të ardhmen.



ITE-DAYS AT EXPOCITY ALBANIA

Ditët e Panairit Ndërkombëtar të Turizmit dhe Mjedisit që u zhvilluan nga 2-4 Qershor 2022 në ambientet e EXPOCITY Albania, hapën dyert edhe për aktivitete dhe prezantime të ndryshme të nxënësve dhe studentëve të ndryshëm nga e gjithë Shqipëria.

Një stendë dedikuar pjesëmarrjes së nxënësve dhe studentëve të degëve turizëm dhe teknologji, qëndroi e hapur për tre ditë rradhazi falë mbështetjes së ofruar nga EXPOCITY Albania, ku publiku i ndryshëm, kompani dhe operatorë turistikë nga i gjithë rajoni u informuan rreth profesionistëve të rinj të fushës së turizmit dhe mjedisit që përgatiten në shkolla të ndryshme profesionale dhe universitete. Ndërsa me datë 3 Qershor 2022 u realizua Konkursi **"Studentët krijojnë, Turistët shijojnë"**.



- Në këtë konkurs morën pjesë 12 ekipe nga 13 të regjistruara, me pjesëmarrës nga shkollat dhe universitetet në vend. Grupet pjesëmarrëse në konkurs ishin:
- 3 Ekipë nga Shkolla Mesme Profesionale "Herman Gmeiner" Tirane
- ATT(Albania Tech Tour);
- Quad4
- Deux

1 Ekip nga Shkolla Mesme Profesionale Teknologji Informimi dhe Komunikimi Korçë

- • TIK Korce

1 Ekip nga Shkolla Teknike Elektrike "Gjergj Canco" Tirane

- Strike

1 Ekip nga Shkolla Mesme Profesionale "Isuf Gjata" Korce

- Korca trip

1 Ekip nga Shkolla Mesme Teknologjike "Hysen Cela" Durrës

- Eunoia

1 Ekip nga Shkolla Mesme Profesionale Hoteleri-Turizëm Tiranë

- New Way

1 Ekip nga Shkolla Mesme Profesionale "Salih Ceka" Elbasan

- New Generation

1 Ekip nga Universiteti: "Fan.S.Noli", Korçë

1 Ekip nga Universiteti Epoka

- Nomadica

1 Ekip nga Universiteti Marin Barleti

- Tourism at Barleti





Ekipet pjesëmarrëse përzgjedhën një nga dy detyrat vijuese:

Detyra 1 :Paketa turistike me e mire 5 ditore Shqiperi(Një kosto e përafërt është e vlerësueshme).

:Zgjidhja më e mirë për sfidat me të cilat po përballlet turizmi sot në Shqipëri (Një kosto e përafërt është e vlerësueshme).



Studentët punuan gjatë gjithë ditës orë, ku zgjeruan më shumë idetë e tyre rreth turizmit të qëndrueshëm si një koncept turistik,

Turizmi dhe Mjedisi, Sfidat e turizmit ne Shqipëri, etj.

Shumë ide kreative, inovatore, praktike u demonstruan nga konkurentët 😊, si :

- Krijimi i një aplikacioni për hiking; kamping nëpër Shqipëri me anë të një harte për vendosjen e çadrave.
- Krijimi i një guide turistike për rajonin e Korçës.
- Krijimi i një strategjie për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm.
- Paketë turistike kombëtare për të gjithë Shqipërinë dhe specifike për rajonin e Korçës.
- Krijimi i një website për rezervimin e hoteleve.
- Krijimi i një aplikacioni, platforme për të njohur turistët me Tiranën dhe të gjithë Shqipërinë.
- Hartimi i një pakete turistike për rajonin e Korçës dhe një tur virtual nëpërmjet syzeve VR.
- Guidë turistike 5 ditore nëpërmjet QR Code për qytete të ndryshme.
- Paketa turistike njëditore për destinacione të paksploruara më përpara.
- Paketë turistike për Shqipërinë e Mesme.
- Paketë turistike për Shqipërinë e Jugut.



Përgjatë punës studentët u mentoruan dhe morën këshilla shumë të vlefshme nga ekspertë të fushave të Teknologjisë dhe Turizmit:

1. Ermiona Braholli, Universiteti “Fan Noli”Korce, doktore shkencash profilizuar ne studimet gjeodiversitet, gjeotrashegimi dhe gjeoturizem
2. Ermira Jashiku, Universiteti “Fan Noli”Korce, doktore shkencash profilizuar ne gjeografi
3. Marjana Murrja, Drejtore Marketing, kompania “LogicAI”,
4. Edison Biba, CoFounder Leeto Digital Agency
5. Zenel Rushi, CoFounder Leeto Digital Agency
6. Labinot Murrja – Founder Butterfly Camping

Prezantimet e studentëve u vlerësuan nga një juri e kualifikuar e përbërë nga:

1. Znj.Aulona Hoxha- CEO Expocity Albania,
2. Z. Erind Sula- Zenith Travel Agency
3. Znj. Marjana Murrja- Marketing & Communications director logical
4. Z. Edison Biba- Co-Founder Leeto Digital Agency
5. Z. Zenel Rrushi- Co-Founder Leeto Digital Agency
6. Z. Labinot Murrja – Founder Butterfly Camping
7. Z Silvi Dedja – Vas Tour Agency
8. Znj Ana Zcharian- CEO Albanian Skills

Dhuratat per fituesit u mundesuan nga:

Albanian Rafting : -Paketë për dhjetë persona rafting në Vjosë

Udhëtim për gjashtë persona në Malin e Tomorrit

Zip Line Albania : -Paketë për dhjetë persona

Butterfly Camping: -Camping për dhjetë persona një natë ku përfshihet Guida-akomodimi-ngrënia(mëngjes+darkë)

Kjo ditë e mbushur me energji pozitive dhe shumë entuziazëm e mbi të gjitha një eksperiencë e vlefshme dhe shumë motivuese për të gjithë, urojme t'i ndihmoje konkurrençën pjesëmarrës ne vijimin e mëtejshëm të ideve të tyre dhe te jete një shtysë mjaft e mirë për karrierën e tyre si profesionistë të ardhshëm të fushës. Nje vleresim i aftësive të te rinjve pjesemarrës u evidentua nga kompanitë pjesëmarrëse gjate mentorimit dhe prezantimit te detyrave.

Në përmbyllje të këtij aktiviteti, falenderojmë shumë përzemërsisht të gjithë të rinjtë për pjesëmarrjen dhe prezantimet dinjitoze, mësuesit dhe pedagogët e tyre për motivimin dhe shoqërimin e tyre përgjatë gjithë ditës por edhe gjatë përgatitjeve si edhe EXPOCITY Albania e partnerët e saj për gjithë mbështetjen në organizimin e këtij konkursi, pa të cilët kjo eksperiencë nuk do të ishte e mundur.

#ITEDays

#Studentëtkrijonëturistëtshijojnë



AKTIVITET E ARDHSHE

Thirrja e pestë e mobilitetit për studentë- e mbyllur

Është mbyllur thirrja e pestë për praktikë njëmuajore në kuadër të projektit INTERVET. Me këtë thirrje do të përzgjidhen 20 nxënës nga të gjitha shkollat profesionale të Shqipërisë të cilët do të nisen në qershor 2022 për 1 muaj në Itali dhe Spanjë dhe 4 studentë për 3 muaj në Francë.

Aplikimet janë në proces përzgjedhjeje dhe fituesit do të shpallen së shpejti. Përpara nisjes, studentët do të marrin një kurs online të anglishtes për të përmirësuar komunikimin në vendin pritës.



Mesueset Job Shadowing, Maltë

Është mbyllur thirrja e dytë ku do të përzgjedhen 3 mësues / staf nga të gjitha shkollat e AFP-së në Shqipëri, të cilët në Tetor 2022 do të shkojnë në Malta.



Eksperienca ime

Kelvin Zifla impresionet përgjatë realizimit të kursit parapërgatitor të Anglishtes me nxënësit. Përgatitja e nënsve ë shtë një nga hallkat e rëndësishme të projektit dhe në buletin e ardhshëm do të njihemi me përshypjet që ka pasur profesori i kursit.



Shkolla Teknike Ekonomike

Anila Nanaj(Bani) Drejtore e Shkollës Teknike Ekonomike Tiranë tregon eksperiencën e saj, pjesëmarrjen e nxënësve pjesëmarrës në Mobilitete por dhe sfitad e hasura.



Lëvizshmëria e nxënësve

Nxënësit pjesëmarrës në mobilitetet në Lyon të Francës dhe Maribor të Sllovenisë na tregojnë eksperiencën e tyre. Ndjesitë pozitive, emocionete bukura, sfidat që kanë kaluar përgjatë kësaj eksperience. Por si dhe aktivitetet e realizuara, përshtatja në kompanitë pritëse dhe me vendin ku ato kanë jetuar për rreth një muaj.

